



**Ambasciata d'Italia  
Pristina**

**DOKUMENTET E NEVOJSHME PER  
HEQJEN E NDALESSES SE HYRJES NE TERRITORIN KOMBETAR  
KERKESË E VECANTE PER RIHYRJE NE TERRITORIN KOMBETAR**

I nderuar aplikues,

në bazë të nenit 19 të Dekretit të Presidentit të Republikës n. 394/99 të modifikuar nga D.P.R. 334/04, ndalesa e hyrjes fillon nga data në të cilën Ju, në bazë të dekretit të përjashtimit, keni lëshuar territorin shtetëror italian, e cila, në bazë të nenit 8 paragrafi 1 të të njëjtit Dekret, vërtetohet nga vula dalëse ose nga dokumente të tjera që dëshmojnë mospraninë Tuaj në territorin e Shtetit.

**KUJDES: Ju kujtojmë që edhe pas përfundimit të periudhës së sinjalizimit heqja e emrit Tuaj nga terminali shtetëror dhe Schengen NUK është automatike.**

Procedurat për heqjen e ndalesës së hyrjes janë si më poshtë vijon:

**Persona me afat ndalese akoma aktiv**

**Në këtë kategori hyjnë të gjithë ata persona të cilët kanë pasur një dekret përjashtimi, të lëshuar nga autoritetet kompetente të çdo Shteti Schengen , afati i ndalesës së të cilit, në bazë të sqarimit të mësipërm, është akoma aktiv.**

Në këtë rast Ambasada Italiane në Prishtinë, në bazë të nenit 25 të Marrëveshjes së Aplikimit të Konventës Schengen, të datës 14 qershor 1985, do të trajtojë vetëm ato kërkesa, të bëra nga banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës, me të cilat kërkohet **rihyrja në territorin italian** pavarësisht nga autoriteti shtetëror Schengen që ka lëshuar Dekretin e përjashtimit.

*Dokumentet e nevojshme:*

- **kërkesa e veçantë për rihyrje në territorin italian, e hartuar në gjuhën italiane në bazë të nenit 13 paragrafi 13 i D.Lgs 286/98 – ISTANZA DI SPECIALE AUTORIZZAZIONE DI RIENTRO IN ITALIA;**
- **fotokopje e një letërnjoftimi valid;**
- **fotokopje eventuale e Dekretit të përjashtimit;**
- **Vërtetimin përkatës nga Ministria e Punëve të Brendshme të Italisë lidhur me statusin Tuaj;**
- **dokumentacion që vërteton qëllimin e kërkesës për rihyrje në territorin kombëtar.**



**Ambasciata d'Italia  
Pristina**

**KUJDES: Ambasada nuk ka të drejtë hyrjeje në të dhënat Tuaja personale, Ju mund të ushtroni të drejtën Tuaj për verifikimin, ndryshimin apo fshirjen e të dhënave Tuaja të pranishme në Sistemin e Informimit Schengen duke iu drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Italisë, Departamenti i Sigurisë Publike, Zyra e Koordinimit dhe e Planifikimit të Forcave të Policisë, Seksioni N.S.I.S. që gjendet në këtë adresë:**

**Ministero dell'Interno  
Dipartimento Pubblica Sicurezza  
Ufficio Coordinamento e pianificazione delle forze di polizia  
Divisione N.S.I.S.  
Polo Anagnina, Palazzina B  
Via di Torre di Mezzavia, n.9  
00173, ROMA  
ITALIA**

**KUJDES: pas pranimit të dokumentacionit përkatës, zyrtari i Ambasadës Italiane, përgjegjës mbi procedurën administrative, pas verifikimit të përmbushjes së dispozitave ligjore në fuqi, do të lëshojë një vërtetim mbi hapjen e procedurës administrative përkatëse nëpërmjet së cilës Ju do të informoheni mbi detajet e saj.**

AMBASADA ITALIANE NE PRISHTINE